

# RAPORT

## I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit “Master i Shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”,

me profile: “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”,

Kolegji Univesitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

Prof. As. Etleva Bajrami



Prof. As. Gentiana Sharku



Korrik/2019

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile: “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”**

Nr.	Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Ekonomisë/ Departamenti i Administrim Biznesi
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër MAS Nr. 567, datë 02.12.2016 (bazuar në VKA Nr. 196, datë 17.10.2016)
4	Titulli i programit të studimit:	Master i shkencave në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile: “Financë dhe Bankë”, “Kontabiliteti dhe Auditim”
5	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
10	Programi ofrohet nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Aktivizimi i programit të studimit	2017-2018
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2018-2019
17	Numri i studentëve	22 studentë

## HYRJJE

### **Të dhëna për programin e studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile: “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim” dhe Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”**

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është licencuar në vitin 2011 me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 781, datë 10/11/2011. Në këtë vendim është licencuar me emërtimin Shkolla e Lartë Universitare Private “Instituti Kanadez i Teknologjisë” i cila organizohet në dy Fakultete:

**1. Fakultetin e Ekonomisë** i cili ofron programet e studimit të ciklit të parë *Administrim biznesi* dhe *Administrim biznesi dhe Teknologji informacioni*, dhe

**2. Fakultetin e Inxhinierisë** që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë *Inxhinieri Softuerike* dhe *Inxhinieri industriale*.

Këto programe studimi zgjasin 3 vjet dhe në përfundim studentët fitojnë 180 kredite (ECTS).

Me urdhër Nr. 68, datë 27.02.2012 u lejua fillimi i aktivitetit akademik në përputhje me licencën e dhënë për SHLUP “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Me Urdhër Nr. 139, datë 25.03.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është bërë Akreditimi Institucional i Shkollës së Lartë Universitare Private “Instituti Kanadez i Teknologjisë” në përputhje me Vendimin Nr. 92, datë 02.11.2015 të Këshillit të Akreditimit. Në këtë urdhër jepet organizimi i Shkollës së Lartë Universitare Private “Instituti Kanadez i Teknologji në dy Fakultete, ku secili është i organizuar në 2 departamente dhe një njësi shkencore.

Në përbërje të **Fakultetit të Ekonomisë** ndodhen:

1. Departamenti Administrim Biznesi
2. Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni
3. Njësia e Kërkimit Shkencor “CIRD Ekonomi”

Në përbërje të **Fakultetit të Inxhinierisë** ndodhen:

1. Departamenti i Inxhinierisë Softuerike
2. Departamenti i Inxhinierisë Industriale
3. Njësia e Kërkimit Shkencor “CIRD Inxhinieri”

Me Urdhër Nr. 556, datë 24.11.2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është miratuar Statuti i institucionit Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, në përputhje me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (sipas Vendimit të Senatit Akademik Nr. 69, datë 21.09.2016 të Institucionit).

Gjithashtu, KU “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 116, datë 15.12.2017 dhe Institucioni është akredituar me kohëzgjatjen 5 vite, me afat vlefshmërie deri në 14.12.2022 duke marrë “Certifikatën e Akreditimit” e vlefshme për këtë periudhë akreditimi.

Për vitin akademik 2018-2019, KU “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ofron 11 programe studimi të dy cikleve, përkatësisht: 6 programe studimi të ciklit të parë “Bachelor” dhe 5 programe studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave”.

Me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit Nr. 567, datë 02.12.2016, është licencuar programi i ciklit të dytë të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”. Ky program studimit do të realizohet me 120 kredite dhe me kohëzgjatje 2 vjet (4



semestra). Ky program është hapur në bazë të vendimit Nr. 196, datë 17.10.2016 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Programi ka kaluar dy procese të vlerësimit nga Agjencia Publike e Akreditimit në Arsimin e Lartë (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë) në kuadër të hapjes:

Në vlerësimin e parë, me Vendim Nr. 188, datë 07.07.2016, Këshilli i Akreditimit shprehet që programi të hapet pasi të plotësojë këto mangësi:

- a. Të plotësojë në përmbajtje të pothuajse të numrit më të madh të komponentëve për një program Master i Shkencave në Financë dhe Kontabilitet në dy profilet përkatëse.
- b. Të përmbushë misionin dhe objektivat e programit Master i Shkencave në Financë Kontabilitet në dy profilet përkatëse.

Në vlerësimin e dytë, me Vendim Nr. 196, datë 17.10.2016, Këshilli i Akreditimit shprehet se janë përmbushur kushtet e lëna dhe rekomandon hapjen e programit të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”, ofruar nga KU “Instituti Kanadez i Teknologjisë”. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.

#### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

Përbërja e GVJ: Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Asoc. Dr. Etleva Bajrami dhe Prof. Asoc. Dr. Gentiana Sharku si ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi. Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Emisa Isufaj.

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është njohur me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 02.07.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 133/10 Prot., datë 02.07.2019. KU “CIT” përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 413/2 Prot., datë 09.07.2019 konfirmimin se janë dakord me Draft – Raportin dhe nuk kanë komente. Ekspertët e Vlerësimit u njohën me përgjigjen e IAL dhe finalizuan Raportin.



## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, është hartuar në përputhje me vizionin, misionin dhe objektivat e institucionit. Regullorja mësimore e programit të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimet e MASR, Statutin dhe rregulloren e KU “CIT”. Në nenin 4 të Statutit të Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, shprehet vizioni i institucionit për të përgatitur studentë me aftësi të mbështetura mbi edukimin, vlerat dhe shpirtin etik, mendimin kritik, analitik dhe të orientuar drejt zgjidhjes së problemeve, krativitetit, novacionit dhe lidershit, të cilat ata do t’i përdorin për t’i dhënë formë jetës, karrierës dhe shoqërisë. Sipas të njëjtit nen, Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” ka për mision zhvillimin e aftësive personale dhe mundësive, nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimit të cilësisë së edukimit, në shërbim të vlerave, duke vlerësuar dhe respektuar diversitetin kulturor dhe vlerat e Shqipërisë.

Misionin e tij Kolegji Universitar “IKT” e realizon sipas qëllimeve të përcaktuara në nenin 4 të Statutit të Institucionit:

- a) Ofrimin e arsimit të lartë dhe veprimtarisë krijuese në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.
- b) Zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë akademike që kryhet brenda dhe jashtë vendit;
- c) Formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit, në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.
- d) Thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e inxhinierisë dhe të ekonomisë.
- e) Kryerjen e studimeve kërkimore - shkencore për të zhvilluar e tejçuar aplikime dhe novacione në fushat e kërkimeve të inxhinierisë dhe të ekonomisë.
- f) Të ofrojë mundësitë më të mira për të përfutur nga arsimi i lartë dhe të mësuar gjatë gjithë jetës;
- g) Të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit.

Strategjia e Zhvillimit të CIT 2024 të miratuar me Vendim nr. 11, datë 08.05.2017 të Senatit Akademik, paraqet pesë qëllimet dhe objektivat për secilin qëllim, në bazë të të cilave është ndërtuar programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	

<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Misioni i programit të studimit përputhet me misionin Institucionit të paraqitur në Statutin e KU "CIT" të miratuar me Urdhërin Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Nr. 556, datë 24.11.2016 dhe qëllimet e Institucionit të paraqitura në Strategjinë e Zhvillimit të CIT 2024 të miratuar me Vendim nr. 11, datë 8.05.2017 të Senatit Akademik.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Studimi i tregut i kryer në janar të vitit 2016, jep të dhëna mbi programet e ofruara në fushën e financë-kontabilitetit në IAL publike dhe private, numrin e studentëve të rregjistruar në këto programe, anketimet e nxënësve në shkolla të mesme si dhe alternativat e punësimit të studentëve që mbarojnë këtë program studimi.</p> <p>Programi mban parasysh zhvillimin ekonomik të vendit, nevojat për përgatitjen e specialistëve të aftë për të punuar në fushën e financës, kontabilitetit, ndërmjetësimit financiar dhe auditimit financiar.</p> <p>Programi i studimit pasqyron vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Sipas rregullores mësimore përkatëse, të miratuar nga kryetari i Senatit Akademik, programi i studimit "Master i shkencave" në "Financë dhe Kontabilitet", me profile "Financë dhe Bankë"; "Kontabilitet dhe Auditim", mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "<i>Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë</i>", udhëzimet e MASR, Statutin dhe Rregulloren e KU "CIT".</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të programit të paraqitura në ASCAL, u konstatua që programi i studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Programi "Master i shkencave" në "Financë dhe Kontabilitet", me profile, është licencuar si program studimi i ciklit të dytë, me urdhër të MASHR, nr.567, datë 02.12.2016, lëshuar në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 35, pika 1 e ligjit nr. 80/2015 për "<i>Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë</i>".</p> <p>Për këtë program studimi, është hartuar dhe rregullozja përkatëse e miratuar nga kryetari i Senatit Akademik. Sipas rregullores mësimore, Programi i studimit "Master</p>



	<p>i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, mbështetet në Ligjin nr. 80/2015, date 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. , udhëzimet e MASR, Statutin dhe Rregulloren e KU “CIT”.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e përcaktuar nga KSHK, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, sipas profileve përkatëse “Financë dhe Bankë” ose “Kontabilitet dhe Auditim”.</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Në vitin 2012 Institucioni ka hartuar një plan strategjik me afat pesë vjecar (deri në vitin 2017). Në datë 08.05.2017, Senati Akademik ka miratuar “Strategjinë e Zhvillimit të CIT 2024”.</p> <p>Në “Strategjinë e Zhvillimit të CIT 2024” bëhet një analizë <u>SWOT</u> dhe analiza e objektivave dhe qëllimëve të Institucionit (GAP), me qëllim përmirësimin e programeve të studimeve dhe të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Institucioni ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe objektivat e përcaktuar në statutin e institucionit.</p> <p>Programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, përputhet me strategjinë për zhvillim të Institucionit dhe është hartuar në përputhje me strategjinë pesë-vjecare për zhvillimin e tij.</p> <p>Në hartimin dhe zbatimin e këtij Programi janë mbajtur parasysh plotësimi i kushteve dhe parakushteve të rrjedhura nga Ligji i Arsimit të lartë dhe Udhëzimet përkatëse të MAS.</p> <p>KU “CIT” ka hartuar “Strategjinë e Zhvillimit të CIT 2024” për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve të ofruara prej tij.</p>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

KU “IKT” ofron programe studimi në të 2 nivelet e studimit, të cilat organizohen nga të dy fakultetet. Fakulteti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet” me profile “Financë dhe Bankë” dhe “Kontabilitet dhe Auditim” me vendim të Senatit Akademik është Fakulteti i Ekonomisë, Departamenti i Administrim Biznesit.

Dekani është Autoriteti drejtues i Fakultetit të Ekonomisë. Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Dekani mban titullin Profesor i Asociuar.



Struktura organizative e Fakultetit te Ekonomisë:

- Departamenti i Administrim Biznesit
- Departamenti i Administrim Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit
- Njësia e Kërkimit shkencor CIRD Ekonomi.

Programet që ofrohen nga Fakulteti i Ekonomisë janë programe të ciklit të parë të studimit dhe programe të ciklit të dytë të studimit.

Cikli i parë i studimeve (BACHELOR) ofron programet:

1. Administrim Biznesi (BA)
2. Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni (BA&IT)
3. Financë dhe Kontabilitet (FA)

Në ciklin e Dytë të Studimeve (MASTER I SHKENCAVE) ofrohen programet:

1. Administrim Biznesi - MBA (tre profile)
2. Financë dhe Kontabilitet –MFA (dy profile)

Kohëzgjatja e studimeve të Master i Shkencave në “Financë dhe kontabilitet me profile: Financë dhe bankë; Kontabilitet dhe auditim” është 2vite/ 4semestra me kohë të plotë.

Departamenti i Departamentit të Administrimit të Biznesit ka gradwn shkencore “Doktor” i shkencave.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)**

Autoritetet drejtuese akademike të KU “Instituti Kanadez i Teknologjisë” janë:

- Senati Akademik
- Rektori
- Zv.Rektori
- Dekani
- Përgjegjësi i Departamentit

Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë drejtues akademik. Rektori është autoriteti më i lartë akademik. Rektori zgjidhet nga anëtarët e Senatit Akademik. Rektori drejton dhe përfaqëson KU në marrëdhënie me të tretët për çështje Akademike. Ai është kryetar i Senatit. Ushtron kontrollin e ligjshmërisë së mbi autoritetet drejtuese të njësive kryesore. Rektori lëshon diplomat në fund të studimeve të programeve të studimeve të organizuara nga KU “IKT”. Rektori harton planin disa vjecar të KU, harton planin vjetor, harton dhe propozon projektbuxhetin, etj. Rektori miraton planin kalendarik të procesit mësimor. Rektori emëron Dekanët e Fakulteteve përbërëse të KU-së. Rektorati është organ ekzekutiv i cili monitoron implementimin e vendimmarrjeve. Rektorati përbëhet nga Rektori, zv.Rektori, Dekanet e të dy fakulteteve, dhe Administratori i KU “IKT”.

Dekani është organ kolegjal ekzekutiv i njësive kryesore përkatëse. Dekani është autoriteti drejtues i Fakultetit të Ekonomisë. Dekani drejton dhe përfaqëson Fakultetin e Ekonomisë. Dekani harton planin disa vjecar të njësisë kryesore konkretisht të Fakultetit të Ekonomisë, harton programin vjetor, harton dhe propozon projektbuxhetin e Fakultetit, etj. Dekani emëron drejtuesit e njësive bazë. Ai ngre komisionin ad hoc të rekrutimit, miraton komisionet e provimeve të formimit, etj.

Përgjegjësi i Departamentit është autoriteti drejtues i njësisë bazë Departamenti i Administrimit të Biznesit. Ai drejton dhe përfaqëson njësinë, kontrollon punën mësimore dhe shkencore të personelit të njësisë bazë. Ai përzgjedh se bashku me dekanin në komisionin e rekrutimit stafin me kohë të plotë dhe të pjesshme.

Asambleja e personelit akademik është organ akademik kolegjal vendimmarrës i njësive kryesore. Asambleja përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i njësive kryesore. Detyrat përgjegjësitë, kompetencat e secilit nga organet drejtuese akademike në lidhje me programin e studimit janë të përcaktuara qartë në Librin e Rregulloreve, Statutin e KU "IKT", Rregulloren Institucionale, Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë, Rregulloren e Departamentit Administrim Biznesi dhe Rregulloren e programit të studimit.

**Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (plotëso Tabelat ne aneks)**

Personeli akademik është me kohë të plotë dhe të pjesshme. Organet drejtuese te Fakultetit të Ekonomisë kanë si qëllim angazhimin e një stafi të përgatitur dhe specialistë të ekonomisë, të cilët kanë studiuar brenda dhe jashtë vendit ne universitete të njohura. Synimi i fakultetit të Ekonomisë është angazhimi i një stafi të kualifikuar jo vetëm në mësimdhënie por edhe ne kërkim shkencor.

Të tre departamentet përbërës të Fakultetit të Ekonomisë përmbushin numrin minimal të personelit akademik efektiv prej 7 anëtarësh, Njësia e Kërkimit shkencor CIRD Ekonomi ka 8 pedagogë efektivë. Gjithashtu departamenti i Administrimit të Biznesit te Fakultetit të Ekonomisë ka në përbërje të tij 3 pedagogë efektive më grada dhe tituj. Të njëjtin numër stafi efektiv 3 me grada dhe tituj ka edhe Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit. Të dy këto departamente kanë pedagogë që janë të rregjistruar për marrjen e gradës "Doktor". Ndërsa Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi ka në përbërje të saj 5 pedagogë me grada dhe tituj.

Personeli Akademik është i qëndrueshëm. Ka shumë pak ndryshime në personelin e Departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë. Personeli i Departamentit të Administrimit të Biznesit që është përgjegjës për programin e studimit ka ndryshim, është larguar një pedagog dhe është transferuar një pedagog nga Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit tek Departamenti i Administrimit të Biznesit, gjithashtu ka shtim në personelin PAK për vitin 2018-2019. Personeli i Njesisë së Kërkimit shkencor CIRD Ekonomi ka ndryshim, është larguar një pedagoge Msc dhe janë rekrutuar 2 pedagogë me tituj. Ky departament është i rëndësishëm sepse në programin "Master i shkencave" në "Financë dhe Kontabilitet" me profile, janë të angazhuar 3 pedagogë të këtij departamenti. Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit është larguar një pedagog, nje tjetër është transferuar drejt Departamentit Administrim i Biznesit dhe janë rekrutuar 2 pedagogë ku njëri është me titull.

Ndryshimet e personelit kanë qenë të pakta dhe kanë synuar personel të ri me grada dhe tituj.

*Nga vizita në Institucion dhe përditësimi i dokumentacionit u konstatua se është ndryshuar Përgjegjësi i Departamentit të Administrimit të Biznesit, që është edhe Departamenti përgjegjës për ofrimin e programit Mastër i Shkencave në "Financë dhe Kontabilitet", me profile. Është rekrutuar edhe një pedagog PAK, i cili nuk është tek të dhënat e RVB për vitin 2018-2019.*

*Ka ndryshim edhe ne Departamentin e Administrimit të Biznesit dhe Teknologjisë së Informacionit, është larguar një pedagog PAK për vitin 2018-2019.*

*Ka ndryshim në Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi, ku është shtuar personeli akademik PAE me 1 personel me titull dhe grade për vitin 2018-2019.*

*Në tabelën e personeli për Departamentin e Administrimit të Biznesit në RVB janë 2 personel me tituj dhe 2 me grada. Nga Vizita janë 1 me titull dhe 2 me grada. Tek Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi në RVB paraqiten 2 me tituj dhe 2 me grada, nga vizita dhe tabelat perfundimtare të marra gjatë vizitës rezultojnë 3 me tituj dhe 2 me grada.*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
--------------------	-----------------------------



**Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.**

**Kriteri 1** Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;

**Kriteri 2** Institucioni ka së paku dy Fakultete;

**Kriteri 3** Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;

**Kriteri 4** Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;

**Kriteri 5** Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është i organizuar në mënyrë që të përmbushë misionin e tij si në drejtim të ofrimit të arsimit të lartë ashtu edhe në kryerjen e studimeve kërkimore shkencore. Secili nga organet dhe autoritet drejtuese akademike ka një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi.

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” përbëhet prej dy fakulteteve:

- Fakulteti i Inxhinierisë
- Fakulteti i Ekonomisë

Të dy fakultetet kanë në strukturën e tyre nga 2 departamente dhe njësi kërkimore, të cilat i shërbejnë zhvillimit të procesit mësimor si dhe kërkimin shkencor si për stafin akademik në procesin kërkimor ashtu edhe për studentët. Departamentet funksionojnë në bazë të rregullores që përcakton kopetencat, detyrat dhe funksionet si në drejtim të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarinë administrative e komunitare. Këto kryhen në përputhje dhe përmbushje të misionit dhe vizionin e Institucionit të përcaktuara në Statutin e Institucionit dhe Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë.

Fakulteti i Ekonomisë ka në përbërje dy departamente:

- Administrim Biznesi (BA)
- Administrim Biznesit dhe Teknologji Informacioni (BA&IT), dhe
- Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi:

Fakulteti i Inxhinierisë ka në përbërje dy departamente:

Të tre departamentet e mësipërme kanë në përbërje të vet të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik dhe ndër ta janë të paktën 3 me gradën shkencore “Doktor”.

Departamenti Administrim Biznesi ka 3 PAE me gradën shkencore “Doktor”

Departamenti Administrim Biznesi dhe Teknologji Informacioni ka 3 PAE me gradën shkencore “Doktor”

Njësia e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi ka 5 PAE me gradën shkencore “Doktor”



**Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

Njësitë kryesore dhe njësitë bazë janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve.

Institucioni ka hartuar Statutin dhe Rregulloren e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”. Institucioni ka hartuar rregulloren e Fakultetit Ekonomik ku janë përcaktuar përgjegjësitë dhe objektivat që duhen përmbushur për realizimin e misionit të fakultetit.

Është hartuar rregullore e veçantë për njësinë bazë, Departamentin e Administrimit të Biznesit duke përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe kompetencat e departamentit në funksion të mbarëvajtjes së aktivitetit mësimor dhe shkencor. Institucioni ka hartuar rregullore për programin “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile “Financë dhe Bankë” dhe “Kontabilitet dhe Auditim”. Në rregullore specifikohen objektivat dhe qëllimet e këtij programi. Në këtë rregullore përcaktohet struktura e programit, kriteret e pranimit në Master dhe të gjithë elementet e nevojshme për mbarëvajtje të procesit mësimor.

Përgjegjësi i departamentit propozon hapjen e pozicionit të ri apo nevojën për staf të ri, propozim që miratohet nga Dekani dhe fillojnë procedurat e rekrutimit. Njësia bazë dhe kryesore të përfaqësuar nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani përzgjedhin se bashku me dekanin në komisionin e rekrutimit stafin me kohë të plotë dhe të pjesshme. Kompetenca dhe detyra këto të përcaktuara në Statutin e KU “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” është i organizuar në mënyrë që të përmbushë misionin dhe vizionin e tij si në drejtim të ofrimit të arsimit ashtu edhe në kryerjen e studimeve kërkimore shkencore. Secili nga organet dhe autoritet drejtuese akademike ka një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi.

Të dy fakultetet kanë në strukturën e tyre nga 2 departamente dhe njësi kërkimore, të cilat i shërbejnë zhvillimit të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Departamentet kanë në përbërje të vet të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik me të paktën 3 anëtarë me gradën shkencore “Doktor”.

Institucioni ka hartuar Statutin dhe Rregulloren e Kolegjit Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”. Institucioni ka hartuar rregulloren e Fakultetit Ekonomik, rregullore të veçantë për njësinë bazë, Departamentin e Administrimit, Rregullore për programin “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile “Financë dhe Bankë” dhe “Kontabilitet dhe Auditim”.

Në statut dhe në rregullore janë përcaktuar qartë përgjegjësitë, kompetencat dhe objektivat që duhen përmbushur si nga njësitë kryesore ashtu edhe nga njësia bazë në realizimin e misionit të synuar me anë të ofrimit të programit të studimit.

Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Personeli akademik dhe drejtuesit e Fakultetit dhe Departamentit kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e IAL, këshillim për studentët, detyra administrative, në përputhje me detyrat e përcaktuara në statutin e Kolegjit Universitar "CIT" dhe të rregulluara me Kontratën Individuale të Punës, e cila bazohet në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

Mësimdhënia në këtë program studimi mbulohet nga Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK). Mësimdhënia mbulohet nga pedagogë të Departamentit të Administrim Biznesit dhe të Departamentit të Biznesit dhe Teknologjisë të Fakultetit të Ekonomisë si edhe nga pedagogë të Fakultetit Inxhinierisë.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat ne aneks)**

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **8 pedagogë gjithsej**, nga të cilët **5** janë Personel Akademik Efektiv (PAE), **3** janë Personel Akademik me Kontratë (PAK). (Sipas Tabelës Nr. 5 në Aneks)

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë program për vitin akademik është  $5 / 8 = 62,5 \%$ .

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik 2017 – 2018 ka qene **5/3**.

Për vitin akademik **2018-2019** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **9 pedagogë gjithsej**, nga të cilët **8** janë Personel Akademik Efektiv (PAE), **1** është Personel Akademik me Kontratë (PAK).

(Sipas Tabelës Nr. 5 në Aneks)

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë program per vitin akademik është  $8/9 = 88,89 \%$ .

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik 2018 – 2019 ka qene **8/1**.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatorit/ët e programit të studimit (plotëso Tabelat ne aneks)**

Këshilli shkencor i programit të studimit Master Shkencor në "Financë dhe Kontabilitet" përbëhet nga tre pedagogë efektivë: një pedagog me titull "Profesor" (Kryetari i këshillit), një pedagog me titull "Profesor i Asociuar" dhe një pedagog me gradën "Doktor i Shkencave", sic tregohet në Tabelën nr. 3.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelat ne aneks)**

Për vitin akademik **2017-2018**, nga **8** pedagogë të angazhuar gjithsej (5 - PAE dhe 3 - PAK): **2** pedagogë kanë titullin Profesor (PAE), **2** pedagogë kanë titullin "Profesor të Asociuar" (1 - PAE dhe 1 - PAK) dhe **4** (2 - PAE dhe 2 - PAK): kanë gradën "Doktor i Shkencave".



Për vitin akademik **2018-2019**, nga **9** pedagogë të angazhuar gjithsej (8 - PAE dhe 1 - PAK): **3** pedagogë kanë titullin Profesor (PAE), **2** pedagogë kanë titullin "Profesor të Asociuar" (1 - PAE dhe 1 - PAK) dhe **4** (PAE) kanë gradën "Doktor i Shkencave".

**Të dhënat sipas seksit. Të dhëna sipas moshës së personelit (Plotëso Tabelat ne aneks)**

Për vitin akademik **2017-2018**, nga **8** pedagogë të angazhuar gjithsej (5 - PAE dhe 3 - PAK): **2** i përkasin gjinisë femërore (1 - PAE dhe 1 - PAK) dhe 6 i përkasin gjinisë mashkullore (4 - PAE dhe 2 - PAK).

Për vitin akademik **2018-2019**, nga **9** pedagogë të angazhuar gjithsej (8 - PAE dhe 1 - PAK): **1** i përket gjinisë femërore (PAE) dhe 8 i përkasin gjinisë mashkullore (7 - PAE dhe 1 - PAK).

Të dhënat paraqiten në tabelën nr. 6.

**Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat (Plotëso Tabelat ne aneks)**

Marrdhëniet e punës midis së personelit akademik rregullohen nëpërmjet kontratave të punës pa afat dhe kontratat e punës me afat, që lidhen midis personelit akademik dhe Rektorit të KU "CIT". Kontratat e punës bazohen në Ligjin Nr. 7691 date 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, ligji nr. 7703 date 11/05/1993 i ndryshuar; ligji nr. 7870 datë 13/10/1994 i ndryshuar; ligji nr. 8434 datë 28/12/1998 i ndryshuar; ligji nr. 9887 datë 10/03/2008; ligji nr. 10221 date 04/02/2010, si dhe statutit, rregulloret dhe aktet e tjera normative të aorganeve kopetente të KU "CIT".

Në kontratë pasqyrohen të drejta dhe detyrimet e punëdhënësit, të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit, dokumentacioni që duhet të përmbajë dosja e secilit punonjës, paga, kohëzgjatja e kontratës, masat disiplinore në rast mosrespektimi të detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kontratë, dhe mënyrat e zgjidhjes së kontratës dhe mosmarrëveshjeve që lindin midis palëve, etj.

Personeli akademik mund të jetë me orientim mësimor dhe/ose kërkimor- shkencor. Sipas statutit (neni 59) të KU "CIT", në varësi të rolit dhe veprimtarisë që kryen, personeli akademik kategorizohet në: a) profesorë; b) lektorë; c) asistent-lektorë. Në kategorinë "Profesorë" përfshihen titullarë të lëndëve, ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Ata mbajnë titujt akademikë "Profesor" ose "Profesor i Asociuar" dhe punësohen me kontratë pa afat. Personeli akademik i kësaj kategorie, pas mbushjes së moshës së pensionit, punësohet vetëm me kontratë një vjeçare. Në kategorinë "Lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik që zhvillojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore, të cilët mbajnë gradën shkencore "PhD" ose "Doktor", kanë së paku tre vite eksperiencë në mësimdhënie, para ose pas fitimit të kësaj grade dhe punësohen me kontratë pa afat. Në kategorinë "Asistent-lektorë" përfshihen anëtarët e personelit akademik, që zhvillojnë veprimtari mësimore-kërkimore, kanë së paku diplomën "Master i Shkencave" dhe punësohen me kontratë me kohëzgjatje të caktuar, së paku njëvjeçare, me të drejtë përsëritje.

**Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë (Plotëso Tabelat ne aneks)**

Sipas informacionit të marrë nga RVB, nuk ka staf ndihmës/administrativ vecanërisht për këtë program studimi. Meqënëse numri i studentëve është i vogël, punët administrative mbulohen nga stafi administrativ/ndihmës i KU "CIT".

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

- Formular aplikimi
- Procedura e rekrutimit



- Lista e stafit akademik per programin e studimit
- Raport vlerësimi i pedagogut
- Dosjen e pedagogëve

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Në kontratat e punës dhe të shërbimit janë specifikuar përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të ofruar.</p> <p>Personeli akademik është angazhuar në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. Nevojat e KU "CIT" për personel akademik me grada dhe tituj për këtë program studimi mbulohen nga kryesisht nga PAE, por edhe nga PAK.</p> <p>KU "CIT" zbaton aktet ligjore dhe nënligjore për ngarkesën mësimore. Shpërndarja e burimeve njerëzore midis njësive bazë të Fakultetit është bërë në përputhje me nevojat e Departamenteve si dhe duke mbajtur në konsideratë kualifikimin individual të stafit.</p>
<b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Nga takimet e bëra me stafin e personelit akademik, rezultoi se personeli akademik në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe duke u konsultuar edhe me programe të studimit të ngjashme të institucioneve homologe të huaja hartojnë kurrikulat për programet e studimit.</p> <p>Libri i rregulloreve të KU "CIT" rregullon mënyrën e vetvlerësimit të personelit akademik dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore të tij (Kapitulli II, Paragrafi XI).</p>
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p>	<p>Libri i rregullores së KU "CIT" përcakton procedurat që duhet të ndiqen për rekrutimin e personelit, në përputhje me statutin e institucionit.</p> <p>Për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 8 pedagogë gjithsej, nga të cilët 5 janë Personel Akademik Efektiv (PAE), 3 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK). Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë program per vitin akademik është <math>5 / 8 = 62,5 \%</math>, pra për vitin e parë nuk është plotësuar vlera minimale prej</p>

*gjsun*

*6/11*



<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>70% që kërkohet nga kriteri nr. 2.  Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik 2017 – 2018 ka qene 5/3.  Për vitin akademik 2018-2019 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 9 pedagogë gjithsej, nga të cilët 8 janë Personel Akademik Efektiv (PAE), 1 është Personel Akademik me Kontratë (PAK). Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë program per vitin akademik është <math>8/9 = 89\%</math>, pra është plotësuar vlera minimale prej 70% që kërkohet nga kriterit nr. 2.</p> <p>Sipas Manualit te Brendshem te Cilësise, në kapitullin IV, përcaktohet procedurat e vlerësimit te cilësisë si për sa i përket mësimdhënies, të këshillimit të studentëve dhe kualifikimit dhe kërkimit shkencor. Raporti i vlerësimit të personelit bëhet nëpërmjet një formulari vetvlerësimi që plotësohet nga pedagogu në fund të vitit akademik, dhe që rishikohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani përkatës, si edhe nëpërmjet vlerësimit nëpërmjet pyetësorëve on-line nga ana e studentëve që kryhet nga Zyra e Zhvillimit dhe Planifikimit.</p> <p>Nga vizita në intitucion, GVJ konstatoi se në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv gjenden dosje të personelit, në të cilat përfshihen raportet e vlerësimit gjatë rekrutimit si dhe raportet e vlerësimit nga studentët. Po ashtu në dosjen e personelit në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në Arkiv, GVJ konstatoi se gjenden kopje të njoftimeve, të të dhënave mbi rekrutimin, vlerësimin e kandidatëve, raportet e vlerësimit të tyre si dhe dokumente të tjera të kërkuara.</p>
---	--

**Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.**

<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet” me profile, ofrohet nga Departamenti i Biznesit, i Fakultetit Ekonomik të KU “CIT”. Përgjegjësi i departamentit përgjegjës për këtë program studimi zotëron gradën shkencore “Doktor”, ndërkohë kryetari i këshillit Shkencor të këtij program ka titullin “Profesor”.</p> <p>Sipas informacionit të RVB, titullarët e lëndëve dhe/ose moduleve në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet” me profile, kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”.</p> <p>Rektori, zv/rektori, dekani, dhe përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në këtë institucion.</p> <p>Rregullorja e Programit të studimit “Master i Shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, paragrafi nr. 7, përcakton procedurën e kryerjes së praktikave profesionale, sipas së cilës përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrje e saj janë Dekani i Fakultetit, Përgjegjësi i departamentit përkatës në bashkëpunim me Zyrën e</p>
---	---

*Handwritten signature*

*Handwritten signature*



	Shërbimit të studentëve me njësinë e Kërkimit Shkencor CIRD Ekonomi. Raporti student për pedagogë për këtë program studimi për vitin akademik 2018-2019 është 1,89, që dëshmon se institucioni siguron personel të mjaftueshëm akademik për udhëheqjen e praktikave profesionale.
<b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Sipas rregullores së Programit të studimit “Master i Shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet” me profile, diplomimi bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një punimi diplome, për të cilin studenti duhet të marrë paraprakisht miratimin e pedagogut udhëheqës.</p> <p>Të gjithë pedagogët e angazhuar në këtë program studimi kanë gradën “Doktor”, që do të thotë se udhëheqësi i temës së diplomës e ka gradën “Doktor”.</p> <p>Raporti student për pedagogë për këtë program studimi për vitin akademik 2018-2019 është 1,89, që dëshmon (edhe sipas RVB) se udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 studentë njëkohësisht.</p>
<b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Kapitulli IV, paragrafi 2, përcakton rregullat që duhet të ndiqen për hartimin dhe udhëheqjen e punimit të diplomës, sipas së cilës çdo fillim viti akademik Departamenti organizon një mbledhje për të përcaktuar fushat e studimit ku do përqëndrohen punimet e studentëve; brenda tre javëve pedagogët paraqesin propozimet e tyre mbi tema specifike që mund të udhëheqin; të dhënat mbi temat e ofruara nga departamenti me emrat e pedagogëve përkatës të ofruar për udhëheqje i paraqiten studentëve në formën e një formulari për t’u plotësuar nga ata brenda javës së tetë të semestrit të parë. Paraprakisht studenti merr aprovimin e pedagogut udhëheqës.</p> <p>Udhëheqësit e temave të diplomës zgjidhen nga pedagogë të angazhuar në këtë program studimi, ku spikatin emra të njohur akademikësh, me njohuri të thelluara teorike në fushën e financës dhe kontabilitetit dhe aftësi të spikatura kërkimore në përputhshmëri me fushën që do të hartohet teza e studimit.</p>
<b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Plani mësimor i kërrij programi studimi nuk parashikon orë laboratorike.</p> <p>Institucioni vë në dispozicion përdorimin e të gjitha burimeve njerëzore (personelin akademik dhe administrativ) për përmbushjen e programit të studimit.</p>



**Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

**Kriteri 1** Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

**Kriteri 2** Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Senati Akademik me vendimin nr. 16, date 11/10/2018, për Fakultetin e Ekonomisë, ka miratuar ngarkesën mësimore të personelit akademik.

Sipas RVB ngarkesa mësimore për personelin akademik varion nga një minimum prej 180 orë mësimore në vit akademik në maksimumin prej 300 orë mësimore në vit akademik. Mesatarja e ngarkesës mësimore për personelin akademik vlerësohet të jetë 205 orë mësimore për vit akademik.

**Gjithashtu në bazë të dokumentit të kërkuar nga vizita në institucion (dokumenti nr. 7), vërejmë se ngarkesa maksimale e një pedagogu për këtë program studimi arrin në 228 orë mësimore. Duke mos patur informacion mbi ngarkesën mësimore që mund të kryejnë pedagogët edhe në programe të tjera studimi, mendojmë se kjo ngarkesë konsiderohet normale kur kryhet nga një pedagog me vjetërsi të konsiderueshme në punë.**

**Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

**Kriteri 2** Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

**Kriteri 3** Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Sipas RVB, zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional disponon: të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie; listën e plotë të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme të angazhuar në mësimdhënie për çdo semestër dhe vit akademik.

Në fillim të vitit akademik, senati miraton listën e plotë të personelit akademik me kohët të plotë dhe me kohë të pjesshme që angazhohet për zhvillimin e programit të studimit (vendimin nr. 16, date 11/10/2018).

Për sa i përket rekrutimeve të reja, kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik dhe ndihmës publikohen në Website-n e KU "CIT" ose dhe diku tjetër, për një periudhë minimalisht dy-javore.



#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Personeli akademik, ndihmës dhe administrativ angazhohet për përbushjen e objektivave të programit të studimit.

Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. Në kontratat e punës dhe të shërbimit janë specifikuar përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet në funksion të përbushjes dhe përmirësimit të objektivave të programit.

Kolegji Universitar "CIT" ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. Kolegji Universitar "CIT" ka një zyrë të burimeve njëzëzore, e cila ndjek politikën e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit dhe ruan të gjitha të dhënat për personelin. Procedurat e ndjekura për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit janë ligjore dhe transparente.

Kriteri i PAE/PAK më i madh se 70% nuk është plotësuar vetëm për vitin e parë të këtij programi studimi. Ndërsa për vitin e dytë është plotësuar.

Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Studentët që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.

Institucioni angazhon personel ndihmës dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.

IAL disponon një bazë të dhënash për stafin akademik mbi procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit të tij.

#### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Kolegji Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë" ka pozicionim të përshtatshëm dhe të lehtë për tu arritur nga studentët, stafi pedagogjik, etj.. Drejt KU "IKT" mund të shkohet me linja të ndryshme të transportit publik.

Godina ka një sipërfaqe të mjaftueshme për tu zhvilluar normalisht procesi mësimor. Godina është e pajisur me infrastrukturë bashkëkohore.

Për zhvillimin e procesit mësimor dhe shkencor janë në dispozicion salla mësimi dhe laboratorë kompjuterike. Meqënëse për zhvillimin e mësimin në programin Master i Shkencave në "Financë dhe Kontabilitet" me profile "Financë dhe Bankë" dhe "Kontabilitet dhe Auditim" nevojiten vetëm laboratorët e kompjuterave dhe numri i studentëve është i ulët ata janë të mjaftueshëm. Të gjitha sallat dhe laboratorët janë të pajisur me projektorë, tabelë shënimesh dhe kanë ajër të kondicionuar. Zyrat e stafit pedagogjik janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të tyre mësimor edhe shkencor, si dhe me kushte fizike të përshtatshme.

Biblioteka e institucionit shërben jo vetëm për të ofruar librat e nevojshëm por edhe si salle studimi. Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë, E Hënë –E Premte, ora 09:00 – 13:00 dhe 14:00 – 18:00 dhe të Shtunën 11:00-15:00.

Biblioteka ka një fond të pasur librash profesional për studentët dhe stafin. Titujt janë përzgjedhur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve, stafit administrativ dhe akademik. Në Bibliotekë gjenden titujt në fushën e ekonomisë në përgjithësi dhe financës në vecanti. Biblioteka ka abonim në burimet elektronike të McGraw-Hill Education, nga ku janë përzgjedhur me kujdes burimet e duhura elektronike, që kanë lidhje me degët që studiohen në IKT. Si pjesë e marrëveshjes ofrohet edhe Biblioteka online si për pedagogët edhe për studentët.

Ku "IKT" ka në ambjentin e saj edhe një Bar-Restorant të cilin e frekentojnë edhe studentët edhe stafi.

##### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Mjediset për Programin e studimit**

- Salla për leksione 4
- Klasa për seminare 4
- Salla për aktivitete promovuese 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale 4
- Laboratorë për lëndët/ Laboratorë informatike 4
- Salla për bibliotekë 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 1
- Zyrë informacioni për studentët 1
- Mjedise sportive 1
- Nyje hidrosanitare 9
- Mjedis shlodhes (Bar-Restorant) 1

**Mjediset për stafin:**

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 1
- Zyra për sekretarinë mësimore 1
- Zyrë për financën dhe Burimet njerëtoe 1
- Zyrë për Njësinë e SBC 1
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore/  
Zyra për personelin akademik 5

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	Ku “IKT” ka një vendndodhje të përhershme ku zhvillon veprimtarinë mësimore dhe ka të vendosura zyrat qendrore administrative. Institucioni ndodhet në Zayed Center, në Rr. “Andon Zako Çajupi”, Nr. 6.
<b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Institucioni zhvillon aktivitetin në këto mjedise prej pothuajse 8 vitesh, që prej vitit 2011. Kjo sigurohet nëpërmjet kontratës që IKT ka nënshkruar me pronarët e godinës ku ndodhen këto ambiente.
<b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arrijtjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet” me profile “Financë dhe Bankë” dhe “Kontabilitet dhe Auditim” zhvillohet në një godinë. Në të njëjtën godinë ndodhet edhe stafi drejtues dhe sigurohet menaxhimi efikas dhe kontrolli i vazhdueshëm i ecurisë mësimore në këtë program.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	N/A



**Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

**Kriteri 2** Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 3** Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

**Kriteri 4** Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

**Kriteri 5** Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Institucioni ka marrëveshje me McGraw-Hill Education, nga ku janë përzgjedhur edhe literaturat më të fundit të fushës së ekspertizës duke siguruar tekste mësimore cilësore dhe bashkëkohore. Literatura e vënë në dispozicion prej marrëveshjes me McGraw-Hill Education shërben edhe për tekstet mësimore të të dy fakulteteve.

Biblioteka është e pasur me tituj në fushën e financës, bankës, kontabilitetit dhe auditimit. Institucioni pasuron bibliotekën në mënyrë të vazhdueshme.

Institucioni ofron edhe bibliotekën elektronike. Biblioteka elektronike përmban rreth 200 tituj të rinj dhe bashkëkohor në fushat e studimit të IKT. Librat elektronikë që ekzistojnë në bibliotekën virtuale të IKT, janë nga bashkëpunimi me McGraw-Hill Education, një nga tre botuesit akademikë më të njohur botërorë. Në Bibliotekë gjenden Buletine dhe Revista shkencore. Vet Institucioni boton reviste shkencore periodike.

Përgjegjësi i Departamentit të Administrimit të Biznesit përgjigjet për formulimin e Profileve dhe përmbajtjen lëndore. Pasurimi i bibliotekës me tituj të rinj ndodh në mënyrë të vazhdueshme dhe si pjesë e ofrimit të programeve të studimit. Në fund të vitit akademik, biblioteka dërgon një formular dixhital "Formular për kërkesë librash" për të gjithë personelin akademik, dekanët dhe përgjegjësit e departamentit, duke i lejuar stafit akademik deri në 2 muaj kohë të japin informacione në lidhje me titujt, që ata mendojnë të përdorin, e që duhet të jenë gjëndje në bibliotekë për vitin e ardhshëm akademik. Pas krijimit të listës së materialeve akademike të kërkuar nga instruktorët, biblioteka fillon blerjet ndërkombëtare, duke u siguruar që të gjithë titujt e duhur do të jenë në kohën e duhur në institucion për stafin akademik si dhe për studentët.

Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë, E Hënë –E Premte, ora 09:00 – 13:00 dhe 14:00 – 18:00 dhe të Shtunën 11:00-15:00. Megjithatë institucioni ju mundësonte studentëve aksesimin e bibliotekës edhe përtej këtyre oreve.

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

**Kriteri 1** Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme laboratorë kompjuterik për zhvillimin e projekteve të kursit, klasa për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, zyra për stafin për realizimin e programit të studimit.

<p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p>	<p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Klasat janë të gjitha të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, si kompjutera, projektorë, tabela shënimesh, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	<p>Laboratorët janë të pajisur me kompjutera të cilët mund të aksesohen nga studentët jo vetëm për nevoja mësimore por edhe gjatë punës për projektet e kursit. Ky program studimi nuk ka praktika laboratorike. Praktika profesionale zhvillohet pranë institucioneve dhe bizneseve të ndryshme.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p>	
<p>Ku “IKT” ka një vendndodhje të përhershme ku zhvillon veprimtarinë mësimore. Institucioni zhvillon aktivitetin në këto mjedise prej pothuajse 8 vitesh. Programi i studimit zhvillohet në një godinë.</p>	
<p>Institucioni ka marrëveshje me McGraw-Hill Education, ka abonim në burimet elektronike nga ku janë përzgjedhur edhe literaturat më të fundit të fushës së ekspertizës duke siguruar tekste mesimore cilesore dhe bashkekohore.</p>	
<p>Pasurimi i bibliotekës me tituj të rinj ndodh në mënyrë të vazhdueshme dhe si pjesë e ofrimit të programeve të studimit. Oraret e Bibliotekës janë përshtatur me nevojat e studentëve.</p>	
<p>Institucioni ka në sasi të mjaftueshme laboratorë kompjuterikë për zhvillimin e projekteve të kursit, klasa për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, zyra për stafin për realizimin e programit të studimit.</p>	
<p>Klasat janë të gjitha të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike të nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies.</p>	

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Në bazë të vendimit nr. 781, date 10.11.2011, shkolla e lartë universitare private “Institutio kanadez i Teknologjis”, sot KU “CIT”, është licensuar të ushtrojë veprimtarinë e saj në emër të shoqërisë “T.A.L.M. – Albania” sh.p.k. Nëpërmjet deklaratës së qëndrueshmërisë së nënshkruar nga ortaku i vetëm Ghanim Al Saad, garantohet përmbushja e qëllimeve dhe objektivave të KU “CIT” për një nivel të lartë mësimdhënie dhe kërkimi shkencor.

Kolegji Universitar “IKT” financohet nga tre burime:

1. Tarifat e studimit që paguhen nga ana e studenteve;
2. Financim nga ana e Ortakut, gjë për të cilën ka edhe një letër angazhimi;
3. Donacione të ndryshme që merren nga ana e IKT.

Pasqyrat financiare të IKT certifikohen çdo vit nga Auditi Financiar nëse janë hartuar sipas Standarteve Kombëtra të Kontabilitetit dhe Legjislacionit në fuqi.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



**Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):**

Nga informacioni i paraqitur në RVB, kanë rezultuar të dhënat e mëposhtme.  
Për vitin akademik 2017-2018, të ardhurat kanë rezultuar nga:

- Tarifat për dhe gjatë shkollimit në masën 66%
- Sponsorizimet në masën 21%
- Aktivitetet tregtare në masën 3%

Për vitin akademik 2018-2019, të ardhurat kanë rezultuar nga

- Tarifat për dhe gjatë shkollimit në masën 95%
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione në masën 3%
- Aktivitetet tregtare në masën 2%

**Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)**

Nuk kemi informacion sepse nuk kemi pasqyrat financiare, por vetem raportin e auditit.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Raporti i Auditit

Pasqyrat financiare u kwrkuan por nuk u vunw nw dispozicion nga IAL.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Kolegji Universitar “CIT” kryen çdo vit auditimin e jashtëm të situatës financiare nga një ekspert kontabël i autorizuar konform legjislacionit në fuqi që rregullon veprimtarinë e shoqërive trgtare.</p> <p>Në raportin e auditit përshkruan gjendjen financiare të shoqërisë, pa dhënë informacion të detajuar mbi elementët e pasqyrave financiare.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Kolegji Universitar “CIT” harton një plan të hollësishëm financiar për realizimin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore (plan 2015-2019). Ky plan përmban informacion mbi kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe pajisjeve, mbi të ardhurat nga tarifat e studentëve, sponsorizimet dhe donacionet si dhe nga aktiviteti tregtar. Pjesa kryesore e të ardhurave vijnë nga tarifat e studentëve. (Sipas deklaratës së qëndrueshmërisë financiare të ortakut).</p> <p>Mbështetur në Raportin e Auditit KU «CIT» e ka mbyllur vitin 2018 me humbje, fakt i cili tregon një</p>

pasiguri materiale që mund të vërë në dyshim qëndrueshmërinë financiare në të ardhmen të shoqërisë. E ardhmja financiare e shoqërisë varet nga mbështetja financiare që do të sigurojë asaj ortaku i vetëm. Gjithsesi vazhdimi i aktivitetit dhe përmirësimi i situatës financiare garantohet nga deklarata e qëndrueshmërisë së nënshkruar nga ortaku i vetëm, duke garantuar një qëndrueshmëri financiare të institucionit.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Kolegji Universitar "CIT" auditohet çdo vit nga një ekspert kontabël i autorizuar.

Kolegji Universitar "CIT" harton raport financiar për çdo vit akademik (sipas RVB).

Kolegji universitar "CIT" ka rezultuar me humbje, e cila sipas raportit të ekspertit kontabël vë në dyshim qëndrueshmërinë financiare të institucionit. Për shkak të mungesës së burimeve të tjera të financimit, përveç tarifave të studentëve, e ardhmja financiare e institucionit varet nga mbështetja financiare e ortakut të vetëm.

Për këtë arsye rekomandojmë që KU «CIT» të përpiqet që të gjejë edhe burime të tjera financimi përveç tarifave të studentëve, si aplikime për grante, pjesëmarrje në projekte etj.

## **6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur në nivel institucioni me vendim të Senatit Akademik në vitin 2013. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë.

NJSBC në bazë të kompetencave të saj kryen vlerësimin periodik të rezultateve të aktiviteteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në njësitë kryesore në përputhje me standardet. NJSBC kryen vlerësimin e efikasitetit të programeve të studimit dhe mundësive të punësimit të studentëve. Në fund të çdo semestri, para provimeve, NJSBC organizon anketimin e studentëve nëpërmjet pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies për secilën lëndë të programit të studimit. Pas çdo vlerësimi NJSBC raporti i detajuar mbi rezultatet e pyetësorëve i dërgohet drejtuesve të institucionit si edhe vet stafit akademik. Si një njësi shumë e rëndësishme në përbërje të institucionit, NJSBC është angazhuar në proceset e sigurimit të cilësisë në institucion si dhe në proceset e akreditimit institucional apo atij programor.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organ kolegjal. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë e ka nisur punën që në vitin akademik 2012-2013 me Vendim të Senatit Akademik Nr. 16, datë 22 / 05 /2013. NJSBC përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore (një për secilën njësi); 1 (një) personel i administratës; 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor; dhe 1 (një) ekspert që drejton njësinë. Anëtarët e Njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit të gjitha sa më sipër janë të përcaktuara edhe në "Manuali i Sigurimit të Cilësisë" në institucion i njohur ndryshe edhe si "QAU Handbook".



Në rritjen e cilësisë së mësimdhënies është i rëndësishëm kërkimi shkencor. Në Fakultetin e Ekonomisë është ngritur Njësia CIRD-Ekonomi, e cila fokusohet në kërkimin shkencor, hartimin dhe aplikimin në projektë, aplikime për grante, organizimin e konferencave shkencore, publikime të ndryshme, etj.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:**

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
- Etj

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë zhvillon anketime me studentët në fund të cdo semestri. Me studentët të cilët janë në vit të dytë të Masterit që janë edhe brezi i parë i të diplomuarve janë zhvilluar 3 anketa. Përgjithësisht ka marrë pjesë në anketë 80-90% e studentëve.

Rezultatet e pyetësorëve janë përpunuar tërësisht nga ana e personave përgjegjës për statistikën dhe rezultatet e fituara janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog.

Ndër problemet më kryesore kanë qënë, ato lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontroll, etj.

**Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka në përbërje ekspert, staf akademik si dhe studentë, duke siguruar një larshmëri këndvështrimesh dhe opinionesh. Për marrjen e të dhënave në shërbim të arritjes së përmirësimit të cilësisë në KU "IKT" janë realizuar treza të rrumbullakta ku studentët janë ftuar për të shprehur mendimet e tyre në lidhje me procese të rëndësishme brenda institucionit si dhe pyetësorë me studentët. Pyetësorët janë organizuar në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Kontrolli i brendshëm i cilësisë me anë të pyetësorëve ka analizuar përmbajtjen dhe zbatimin e programit të lëndëve si dhe cilësinë e mësimdhënies. Raport i detajuar mbi rezultatet e pyetësorëve i dërgohet drejtuesve të institucionit Dekanit dhe Rektorit, të cilët ndjekin dhe analizojnë me kujdes rezultatet e përfituara prej pyetësorëve.

Anketimi është realizuar me studentët aktual që vazhdojnë studimet si dhe me ata ALUMNI për të parë nivelin e punësimit të tyre. Rrjeti Alumni është aktiv por studentët e këtij programi ende nuk janë diplomuar.

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti**

Departamenti ka përgjegjësi në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë. Në cdo fillim viti akademik vlerësohet përbërja e programit të studimit nga stafi akademik i departamentit dhe fakultetit përkatës. Nëse sygjerohen ndryshime ato duhet të aprovohen nga Senati Akademik. E njëjta procedurë ndiqet nëse do të sygjerohet mbyllje apo hapje e një programi të ri. Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë senatit, rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve.

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

Një pjesë e vlerësimit të pedagogëve, realizohet nëpërmjet procesit të vetvlerësimit. Të gjitha raportet e vetvlerësimit bashkë me të dhënat e pyetësorëve ndërtojnë panoramën e situatës brenda institucionit mbi procesin e mësimdhënies, funksionimit të njësive bazë, kërkimit shkencor si dhe kontributit për çështje administrative nga ana e stafit akademik.

**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Vetvlerësimet realizohen çdo vit nga stafi akademik. Vetvlerësimi përfshin elementë nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor në mënyrë që të vlerësohet në fund performanca e secilit pedagog. Drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të viti akademik. Në varësi të rezultateve ndërtohen dhe pritshmëritë.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

*Rezultatet e pyetësorëve të drejtuar studentëve.*

*Alumni plan of activities, fokus grup me Alumni, takime të Alumni.*

*Kopjet online të Revistës së CIT*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"><li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li><li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li><li>Pyetje konceptuale;</li><li>Intervista;</li><li>Etj.</li></ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"><li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li><li>Dëgjime në auditor;</li><li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li><li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për</li></ol>	<p>Për sigurimin e cilësisë së institucionit KU "IKT" përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p> <p>Institucioni nëpërmjet NJSBC harton një raport vjetor, ku përfshihen të gjitha metodologjitë dhe instrumentet vlerësuese të përdorura. NJSBC në mënyrë periodike raporton dhe informon organet drejtuese në lidhje me rezultatet e kontrolleve të zhvilluara.</p> <p>Rezultatet e kontrolleve të zhvilluara ju njoftohen edhe stafit.</p> <p>Metodologjia e vlerësimit mbështetet në metodën e vetvlerësimit dhe të pyetësorëve drejtuar studentëve.</p> <p>Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Institucioni përdor metodën e tërthortë të sondazheve të studentëve që ndjekin programin e studimit. Ky program studimi ende nuk e ka diplomuar brezin e parë. Pyetjet në pyetësorë synojnë të tërheqin mendimet e studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, literaturën, kurrikulën, etj.</p> <p>Institucioni ndjek edhe ecurinë e rezultateve të studentëve.</p> <p>Ndërsa stafi kryen vetvlerësimin me anë të raportit të vetvlerësimit. Ky raport i bashkangjitet rezultateve të testit për vlerësimin e përgjithshëm të performancës së pedagogëve.</p>



<p>module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Rezultatet e pyetësorëve janë të përmbledhura, të përpunuara dhe analizuar dhe ju janë komunikuar stafit në mënyrë konfidenciale, jo publike në broshura apo buletine.</p> <p>KU "IKT" nuk publikon vlerësimin e brendshëm në faqen e internetit. Institucioni e vlerëson konfidencial për çdo pedagog këtë informacion.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në mënyrë periodike institucioni kryen analizë vjetore të raporteve të hartuara nga NJSBC. Këto raporte analizohen dhe vendoset për veprime të mëtejshme për rritje të cilësisë së brendshme.</p> <p>Institucioni ka orientim perëndimor të programeve dhe kurrikulave që ofron. Megjithatë departamentet në analizën e tyre vjetore synojnë të orientojnë dhe përditësojnë drejt nevojave të tregut shqiptar dhe atij ndërkombëtar.</p> <p>NJSBC nëpërmjet metodologjisë së vlerësimit për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, cilësisë së mësimdhënies kryen monitorimin e procesit të mësimdhënies në tërësi dhe rezultatet e tyre i raporton pranë senatit, rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve.</p> <p>Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, etj. Programi i studimit synohet të përmirësohet duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët. Rivlerësimi dërgohet për miratim nga Këshilli i fakultetit (Asambleja e pedagogëve), për t'u miratuar më pas nga Senati</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të studimit;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

KU "IKT" ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve.

Institucioni nëpërmjet raportit të vetvlerësimit të pedagogëve, nëpërmjet anketave me studentët dhe tryezat e rrumbullakta harton raportin periodik me anë të së cilit vlerëson ecurinë e cilësisë.

Institucioni ka të hartuar në mënyrë të qartë politikën e procedurës së vlerësimit periodik.

Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit, pasi janë organet kolegjiale të fakultetit të cilat ndjekin në mënyrë konstante ecurinë e programit të studimit. Duke qenë një program i ri vëmendja është maksimale në këtë program studimi.

Institucioni i kushton vëmendje ndërgjegjësimit të stafit akademik dhe atij administrativ mbi sigurimin e cilësisë për programet e ofruara në KU "IKT". Ndërgjegjësimi synon që stafi të jetë në një linjë me misionin dhe vizionin që ka institucioni për të ofruar programe të një cilësie të lartë. Ndërgjegjësimi fillon që gjatë procedurave të punësimit të një anëtari të ri në stafin akademik, duke i shpjeguar vlerat, misionin dhe vizionin e institucionit si dhe duke i kërkuar atij të bëhet pjesë e synimeve të përbashkëta të KU "IKT" për të rritur dhe ruajtur cilësinë në mësimdhënie.

Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Institucioni ka hartuar Planin Strategjik në vitin 2017 me afat 7 vjeçar në të cilin janë vendosur objektivat e synuara në të ardhmen për të realizuar mbarëvajtjen e institucionin dhe rritjen e cilësisë. Objektivat përfshijnë rritje të cilësisë së stafit, kurrikulave si dhe zgjerim të ambjenteve universitare. Institucioni ka miratimin e Strategjisë së kërkimit, zhvillimit dhe krijimtarisë së CIT dhe synon të ndërtoj Kampus Universitar.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Institucioni nëpërmjet NJSBC përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit dhe harton një raport vjetor, ku përfshihen të gjitha metodologjitë dhe instrumentet vlerësuese të përdorura.

NJSBC në mënyrë periodike raporton dhe informon organet drejtuese në lidhje me rezultatet e kontroleve të zhvilluara.

Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor metoda të tërthorta si pyetësorët drejtuar studentëve dhe të drejtpërdrejta si metodën e vetvlerësimit.

Rezultatet e pyetesorëve janë të përmbledhura, të përpunuara dhe analizuar dhe ju janë komunikuar stafit në mënyrë konfidenciale, jo publike.



Programi i studimit synohet të përmirësohet duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët. Ky është program i ri dhe kjo do të jetë një mënyrë e përshtashme për të rivlerësuar programet në të ardhmen. Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Institucioni ka hartuar Planin Strategjik në vitin 2017 me afat 7 vjeçar në të cilin janë vendosur objektivat e synuara në të ardhmen për të realizuar mbarëvajtjen e institucionin dhe rritjen e cilësisë, si dhe ka miratimin e Strategjisë së kërkimit, zhvillimit dhe krijimtarisë së CIT.

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, ka filluar në vitin akademik 2017-2018. Programi i studimit është licensuar bazuar në Urdhërin Nr. 567, datë 02 / 12 / 2016 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për “Hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, “Master i Shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile: “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”. Në përfundim të studimeve në këtë program, studenti ka të drejtën e përfitimit të Diplomës Master Shkencor në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile: “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi**

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet” ka filluar në vitin akademik 2017-2018. Sipas rregullores së programit të studimit programi i studimit synon t’u ofrojë studentëve një diplomë të specializuar në fushat: financë; bankë; kontabilitet dhe auditim. Ky program studimi është konceptuar si një vazhdim/thellim i njohurive të fituara më parë dhe ndërtohet bazuar në programin e studimit bachelor në “Financë dhe Kontabilitet”.

Bazuar në rregulloren e programit të studimit, ky program studimi synon të specializojë studentët potencialë master nëpërmjet një metodologjie teorike dhe praktike, e cila fokusohet në zhvillimin dhe zbatimin e projekteve. Ofrimi i diplomave të specializuara/të përqendruara në financë, bankë, kontabilitet dhe auditim krijon mundësinë për zhvillimin e një karriere të suksesshme si në fushën e financave dhe bankave, ashtu edhe në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

Sipas Rregullores së programit të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, ky program studimi ka për synim që ti pajisë studentët me: njohuri dhe koncepte bazë në fushat e përafërta të studimit si dhe njohuri të thelluara në fushën kryesore të studimit; aftësi për fitimin e një profesioni ose license profesionale; formim teknik dhe praktik sipas fushës së zgjedhur; aftësi për punë kërkimore dhe shkencore; aftësim për promovim personal dhe profesional, etj.

##### **Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)**

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

*[Handwritten signatures]*



- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë**

**(Tabela 10)**

Sipas rregullores së programit të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, viti akademik organizohet me kohëzgjatje normale 2 vite / 4 semestra, të ndarë nga dy semestra në secilin vit, me nga 15 javë secili. Senati Akademik në fillim të çdo viti miraton Planin Kalendarik sipas të cilit bëhet organizimi i procesit mësimor, shpallen provimet e ndërmjetme, ato të fundit të sezonit, mbrojta e diplomave, pushimet verore etj. Mësimdhënia në këtë program bëhet vetën në gjuhën angleze. Për këtë arsye edhe literatura e përdorur në program (sipas programit të lëndëve - silabuseve) është në gjuhën angleze. Programi “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, ka 120 ECTS. Ndarja e krediteve në orë në auditor dhe orë jashtë auditori është bërë sipas udhëzimeve të MASR. Format e mësimdhënies përfshijnë ato të leksioneve, seminareve, projekteve dhe ushtrimeve.

Sipas rregullores së programit të studimit (pika 8.2), pedagogët udhëheqës zhvillojnë seanca konsultimesh me studentët që kanë në udhëheqje. Në planin mësimor për punimin e temës së diplomës janë parashikuar 600 orë jashtë klase, ndërsa seancat e konsultimeve nuk janë pasqyruar.

Duke u mbështetur në planin mësimor të licencuar, vërejmë se 2 lëndë me 12 kredite në total i përkasin kategorisë A, 8 lëndë (nga të cilat 4 me zgjedhje) i përkasin kategorisë B (me 51 kredite në total), 2 lëndë me 15 kredite gjithsej i përkasin kategorisë C, 2 lëndë me 18 kredite gjithsej i përkasin kategorisë E, dhe një lëndë (diploma) me 24 kredite i përket kategorisë F. VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, që është aktualisht në fuqi, përcakton përqindjen e krediteve që duhet të merren sipas secilës kategori disipline. Për shembull për disipinat e kategorisë B kërkohet që përqindja e krediteve të jetë nga 50% në 60%, ndërkohë që sipas planit aktual të licencuar është 42,5%. Rekomandojmë riklasifikimin e lëndëve sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018 që sipas konfirmimeve në institucion pritet të bëhet pasi programi të miratohet.

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:**

Lëndët kanë kredite të ndryshme: nga 6 deri në 9 kredite. Një kredit ka 25 ore punë mësimore në auditor dhe punë të pavarur të studentit Në varësi të krediteve që kanë, orët e punës në auditor dhe jashtë klase për leksione, seminare dhe ushtrime janë të ndryshme për çdo lëndë, sic tregohet në Tabelën 10.

- Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën ne Aneks)**

Gjatë zhvillimit të planit mësimor të programit të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, nuk ka ndryshime në planet mësimore, por ka vetëm shkëmbim të lëndëve midis semestrave të vitit të parë. Lënda “Financë Korporate” është këmbyer me lëndën “Manaxhim i Sistemeve të informacionit” dhe lënda “Kontabilitet Financiar i Avancuar” është shkëmbyer me lëndën “Standardet e raportimit Financiar”. Këto shkëmbime janë miratuar me Vendimin nr. 6 të Këshillit të Fakultetit të Ekonomisë, date 11.10.2018.

- Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës**

Tabela 13 në Aneks.

- Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.**

GVJ konsultoi syllabuset e lëndëve që zhvillohen në programin e studimit “Master i Shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet” dhe konstatoi që programet përmbanin elementët e nevojshshëm për të garantuar një zhvillim cilësor të procesit mësimor. Programet përmbanin elementët e mëposhtëm:



- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

**Analizë e cilësisë së syllabuseve**

Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi se lëndët zhvillohen nga pedagogë kompetentë të fushës, dhe bazoheshin në një literaturë të gjerë bashkëkohore. Ato përmbajnë të dhënat mbi pedagogun e lëndës, objektivat që synon të realizojë lënda, temat që trajtohen, mënyrën e vlerësimit të studentit si dhe detyrime të tjera të studentit dhe pedagogut. Syllabuset ishin pothuaj të standardizuar për të gjitha modulet.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Vendimi mbi shkëmbimin e lëndëve gjatë zhvillimit të planit mësimor

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, është i vlerësuar në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Ky program përmban 120 kredite të shpërndara në 2 semestra, secili me 60 kredite, realizohet në gjuhën angleze dhe zgjat dy vite akademike.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p>	<p>Sipas rregullorës së programit të studimit, “Masteri i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, ka për synim që ti pajisë studentët me: njohuri dhe koncepte bazë në fushat e përafërta të studimit si dhe njohuri të thelluara në fushën kryesore të studimit; aftësi për fitimin e një profesioni ose license profesionale; formim teknik dhe praktik sipas fushës së zgjedhur; aftësi për punë kërkimore dhe shkencore; aftësim për promovim personal dhe profesional etj.</p> <p>Ky program studimi krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë të daktaturës, që është edhe</p>

*[Handwritten signatures]*



<p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>një nga objektivat e ardhshëm të KU “CIT”.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Sipas RVB dhe takimit të GVJ me drejtues të KU “CIT”, studentët që përfundojnë me sukses programin e studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, mund të zhvillojnë karrierë në një gamë të gjerë sektorësh, në institucionet financiare, firmat e kontabilitetit, industri, institucionet publike dhe akademi, si specialist finance, financier buxheti, bankier, specialist kontabël. menaxher portofoli, analist financiar, specialist kredie, specialist auditi, planifikues i specializuar financiar, konsulent financiar, konsulent taksash, konsulent projektsh, etj.</p>
<p><b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat e nivelin e dytë të studimeve.</p> <p>Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e disa elementëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rezultat e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar</li> <li>• Vlerësimi me pikë për aktivizimin në auditor</li> <li>• Vlerësimi i detyrave të kryera.</li> <li>• Vlerësimi projekteve/detyrave të kursit.</li> </ul> <p>Vlerësimet bëhen në procesverbale dhe dorëzohen në sekretari.</p>
<p><b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve evropiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programet e studimit mbështeten në literaturë të huaj bashkëkohore, duke marrë praktikat më të mira të vendeve evropiane. Këtë mundësi KU “CIT” e ka vecanërisht për shkak të marrëveshjes së lidhur me kompaninë botuese McGraw Hill.</p> <p>Duke u mbështetur në literaturën bashkëkohore të huaj, programet e studimit kanë marrë praktikën më të mirë të vendeve të zhvilluara, por sigurisht duke e përshtatur procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor edhe me nevojat e tregut shqiptar.</p>



<b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Për nga vet qëllimi që ka, ky program studimi është orientuar si në aftësimin profesional duke i dhënë rëndësi të vecantë praktikës profesionale që është pjesë e kurrikulës, edhe kërkimit shkencor nëpërmjet punimit të detyrave të kursit, projekteve gjatë vitit dhe duke e finalizuar me punimin e diplomës në përfundim të studimeve.</p> <p>Programi “Master i Shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, është licensuar si program studimi i ciklit të dytë, me urdhër të MASHR, nr.567, date 02.12.2016, lëshuar në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 35, pika 1 e ligjit nr. 80/2015 për “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Sipas RVB KU “CIT” inkurajon personelin akademik që të përfshihet në projekte të ndryshme kërkimore duke përfshirë edhe studentët drejtëpërsëdrejti në projekte, si ndihmës-kërkues apo duke ju dhënë atyre detyra kursi që lidhen me projektet. Antarët e personelit akademik kanë marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe kanë botuar artikuj të ndryshëm me karakter shkencor. Puna kërkimore e stafit akademik është në përputhje dhe në funksion të programeve studimore.</p>
<b>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me n. evojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	N/a
<b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>b. kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ai i përgjigjet kërkesës për përgatitjen e specialistëve në funshën e financës dhe kontabilitetit.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës. Studimi i tregut i kryer në janar të vitit 2016, jep te dhena mbi programet e ofruara në fushën e financë-kontabilitetit në IAL publike dhe private, numrin e studentëve të rregjistruar në këto programe, anketimet e nxënësve në shkolla të mesme si dhe alternativat e punësimit të studentëve që mbarojnë këtë program studimi.</p> <p>Programi mban parasysh zhvillimin ekonomik të vendit, nevojat për përgatitjen e specialistëve të aftë për të punuar në financë dhe kontabilitet.</p>
<b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b>	

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>KU «CIT» ofron programe studimi që janë hartuar në përputhje me politikat kombëtare mbi arsimin e lartë të MASR.</p> <p>Programi Master është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian etj.</p> <p>Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përmbajtjes mësimore dhe veprimtarive kërkimore dhe shkencore, si edhe përfshirjes në disa veprimtari jashtëshkollore me karakter social dhe humanitar.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Programi i studimeve të Masterit të Shkencave “Financë dhe Kontabilitet” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, të shpërndara në dy vite akademike. Praktika së bashku me punimin e diplomës përmbajnë 34 kredite.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Informacioni mbi programet e studimeve në KU “CIT” shpërndahet nëpërmjet formave të ndryshme si afishimit në faqen e internetit të IAL, afishimit në stendat brenda ambjenteve të KU “CIT”, etj.</p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se studentët njihen me syllabuset që në orën e parë të procesit mësimor nga pedagogët përkatës. Syllabusi i ofrohet studentëve si në formë elektronike edhe në formë të shkruar.</p> <p>Pavarësisht se në faqen e web-it insitucioni parashikon të publikojë syllabuset, ato nuk shfaqen për përdoruesit.</p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	

*Handwritten signature*

*Handwritten initials*



<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimeve “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”, me profile, përmban në mënyrë të detajuar edhe procedurën e diplomimit të studentëve.</p> <p>Për kryerjen e intershipit dhe punimin e tezës së diplomës, plani mësimor parashikon 34 kredite ECTS.</p> <p>Sipas rregullores së programit të studimit (pika 8.2), pedagogët udhëheqës zhvillojnë seanca konsultimesh me studentët që kanë në udhëheqje. Në planin mësimor për punimin e temës së diplomës janë parashikuar 600 orë jashtë klase, ndërsa seancat e konsultimeve nuk janë pasqyruar. Rekomandojmë që në të ardhmen të përfshihen këto seanca konsultimi në planin mësimor.</p> <p>Duke u mbështetur në planin mësimor të licencuar, vërejmë se 2 lëndë me 12 kredite në total i përkasin kategorisë A, 8 lëndë (nga të cilat 4 me zgjedhje) i përkasin kategorisë B (me 51 kredite në total), 2 lëndë me 15 kredite gjithsej i përkasin kategorisë C, 2 lëndë me 18 kredite gjithsej i përkasin kategorisë E, dhe një lëndë (diploma) me 24 kredite i përket kategorisë F. VKM nr.41, datë 24.01.2018, që është aktualisht në fuqi, përcakton përqindjen e krediteve që duhet të merren sipas secilës kategori disipline. Për shembull për disiplinat e kategorisë B kërkohet që përqindja e krediteve të jetë nga 50% në 60%, ndërkohë që sipas planit aktual të licencuar është 42,5%. Rekomandojmë riklasifikimin e lëndëve sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018 që sipas konfirmimeve në institucion pritet të bëhet pasi programi të miratohet.</p>
---	--

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, përputhet me strategjinë për zhvillim të Institucionit dhe është hartuar në përputhje me strategjinë afatmesme për zhvillimin e tij.

Në hartimin dhe zbatimin e këtij Programi janë mbajtur parasysh plotësimi i kushteve dhe parakushteve të rrjedhura nga Ligji i Arsimit të lartë dhe Udhëzimet përkatëse të MASR.

Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimet përkatëse të MASR.

Programi i studimit përfshin si aftësim profesional edhe shkencor, për nga vetë natyra specifike e këtij masteri.

Programi i studimit ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Institucioni publikon në web-in e tij informacion për programet e studimit, por në disa raste informacioni mungon, duhet të plotësohet (syllabuset).

Ky program studimi parashikon planin e diplomimit sipas kalendarit akademik në rregulloren e programit përkatës të studimit. Rekomandojmë që në planin mësimor në të ardhmen të përfshihen seancat e konsultimit të parashikuara në rregulloren përkatëse të programit të studimit.

Rekomandojmë edhe riklasifikimin e lëndëve sipas kategorive dhe përqindjeve përkatëse të përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

*[Handwritten signatures]*

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia në këtë program studimi organizohet në funksion të qëllimit të programit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet” me profile “Financë dhe Bankë” dhe “Kontabilitet dhe Auditim”. Studentët që ndjekin studimet në këtë program janë studentë me formim ekonomik dhe kjo mundëson zhvillim interaktiv të procesit mësimor. Studentët punojnë shpesh në grupe në orët e seminareve dhe kjo synon të zhvillojë tek ata bashkëpunimin, zhvillimin e shprehive ekonomike si dhe aftësitë gjykuese dhe vendimmarrëse. Format kryesore të mësimdhënies janë zhvillimi i leksioneve, seminareve dhe projekteve të kursit. Oret e mësimi janë 50 minuta me intervale pushimi prej 10 minutash. Me rëndësi të veçantë janë praktika profesionale dhe punimi i diplomës në fazën përfundimtare të studimeve të cilat synojnë orientim dhe përshtatje të studentit me nevojat e tregut. Institucioni ka hartuar edhe Manualin e Punimit të Diplomës për t’ju ardhur në ndihmë studentëve.

Në mënyrë që organizimi i mësimi të jetë sa më i qartë për studentët, që në fillim të vitit akademik zhvillohet “Java e Tutoriatit” ku studentët njihen me programet dhe syllabuset. Në fillim të zhvillimit të çdo lëndë pedagogët prezantojnë programet e syllabuseve dhe kjo krijon mundësinë për tu njohur me programet dhe qëllimet e tyre. Studentët janë të mirëpritur për diskutime në lidhje me përmbajtjen e programeve, rregulloret e programeve, përmbajtjen e syllabuseve etj. Studentët njihen me universitetin që në fillim të hyrjes me anë të Guidës së Studentit.

Me synim të përmirësimit të programit të studimeve dhe të planit mësimor të programit MASTER I SHKENCAVE në “Financë dhe Kontabilitet”, KU “IKT” ka zhvilluar edhe tryeza të rumbullakta me ekspertë të fushës për të tërhequr mendime. Cilësia e mësimdhënies, realizohet me organizimin e lëndëve, përzgjedhjen e literaturës (përmes marrëveshjes me McGrawHill Education), si dhe mjeteve e metodave të larmishme didaktike të përdorura gjatë leksioneve dhe seminareve.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:**

- |                         |         |
|-------------------------|---------|
| • Leksione              | 420 orë |
| • Seminare              | 174 orë |
| • Ushtrime              | 352 orë |
| • Laboratore            |         |
| • Praktikë lëndore      | 4 orë   |
| • Praktikë profesionale | 300 orë |

##### **Format e kontrollit të njohurive**

Kontrolli i njohurive të studentëve realizohet në mënyrë të vazhdueshme. Ai kryhet nëpërmjet provimit të ndërmjetëm, aktivizimit dhe pjesëmarrjes në diskutime, prezantimeve dhe dorëzimeve të projekt/detyrë kursit dhe provimit përfundimtar, kjo e organizuar sipas lëndëve. Në këtë mënyrë nota përfundimtare që tregon edhe njohuritë e studentit është rezultat i kombinimit të disa formave të mësimdhënies përgjatë gjithë semestrit kur zhvillohet lënda. Në këtë mënyrë edhe vlerësimi i njohurive është një proces i vazhdueshëm duke qenë me objektiv dhe realist.

##### **Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Institucioni i kushton vëmendje maksimale stimulimit të studentëve dhe bërjen e tyre pjesë aktive të institucionit. Institucioni ju ofron mundësi mobilitetesh dhe pjesëmarrje në Konferenca shkencore. Ky program është ende i ri dhe numri i studentëve është i ulët dhe fakti që shumica janë në marrëdhënie pune ndikon në vendimmarrjen e tyre për të mos qenë pjesë e mobiliteteve.

Për këtë vit është planifikuar zhvillimi i Konferencës studentore në bashkëpunim me një Universitet tjetër privat.

*Handwritten signatures in blue ink.*



Ora e mësimit në RVB është shënuar 60 minuta, ndërsa nga takimet në institucione u saktësua se është 50 minuta me intervale pushimi 10 minutëshe.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Evidenca te organizimeve të tryezave të rumbullakta.

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

KU "CIT" ka miratuar procedurat për regjistrim në programin e studimit "Master i shkencave" në "Financë dhe Kontabilitet", me profile, në rregulloren e programit përkatës së studimit. Sipas kësaj rregulloreje, aplikantët duhet të kenë përfunduar studimet e Ciklit të Parë në fusha të njëjta, (ku konsiderohen financa, biznesi dhe ekonomiksi) ose të përafërta. Përshtatshmëria e kandidatave që vijnë nga fusha të përafërta do të trajtohet rast pas rasti nga një komision i ngritur nga dekani në nivel fakulteti. Por gjatë vizitës, GVJ iu komunikua se gjatë dy viteve të zhvillimit të këtij program studimi nuk ka patur student nga fusha të përafërta dhe nuk ka qenë e nevojshme procedura e ngritjes së komisionit. Kriter tjetër është përmbushja e kriterit të gjuhës angleze sipas paragrafit 4 të nenit 76 të Ligjit nr. 80, datë 22 / 07 /2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë"; udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe kriteret e pranimit të gjuhës angleze në CIT.

Dokumentacioni për regjistrim dorëzohet nga i interesuari në Zyrën e Pranimit të Studentëve, e cila ndjek procedurën për regjistrimin e tij. Dokumentet plotësuese që vërtetojnë aftësitë dhe eksperiencat e kandidatëve për studime në "Master i shkencave" në "Financë dhe Kontabilitet", me profile, konsiderohen si vlerësime pozitive për kandidatët.

Në fillim të vitit akademik organizohen javët orientuese, ku mbahen takime dhe leksione për shpjegimin e sistemit të studimeve, të rregulloreve dhe të procedurave administrative në CIT për studentët e rinj. Kriteret e regjistrimit miratohen çdo vit dhe bëhen publike në të gjitha format e mundshme. Kriteret janë të detajuara sipas Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Udhëzimeve të MASR.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

**Procedurat e pranimit të studentëve**

Kriteret e pranimit të studentëve janë të formuluar në Rregulloren e programit. Kriteret dhe procedurat e pranimit, janë gjithashtu të publikuara për të interesuarit.

**Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Gjatë vizitës GVJ iu komunikua se preferohen studente me mesatare minimale 7,5.

Programi i studimit Master i Shkencave në "Financë dhe Kontabilitet" në vitin akademik 2017-2018 ka patur studentë të regjistruar në vitin e parë me mesatare 7,77.

Ndërsa gjatë vitit të dytë janë regjistruar 17 studente me mesatare 7,36.

*Handwritten signatures:*  
GSM  
GWR

Deri tani, IKT nuk ka diplomuar asnjë student në programin e studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, por ndërkohë në nivel fakulteti dhe institucioni, tashmë është formuar edhe struktura e Alumni, pjesë e së cilët janë të gjithë studentët e diplomuar.

**Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

Tabela 7

**Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare**

Nuk ka studentë të diplomuar, pasi nuk ka mbaruar akoma viti i dytë akademik.

**Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Studentwt e kwtij programi nuk kanw kryer mobilitet, pasi kanw tw angazhuar me punw.

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

Studentët e rregjistruar në vitin 2017-2018 janë të gjithë në punë dhe nuk janë të interesuar për mobilitet. Ndërkohë nuk ka studentë të diplomuar.

**Numri total të diplomuarve**

Nuk ka studentë të diplomuar.

**Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

Nuk ka të dhëna sepse nuk ka të diplomuar. Gjithsesi studentët e vitit të dytë dhe një pjesë e studentëve të vitit të parë janë të punësuar.

**Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)**

Nuk ka të dhëna sepse nuk ka të diplomuar.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Dosja e studentit,

Rregjistri themeltar

Rregjistri i lëndëve mësimore

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Studentët që janë rregjistruar në programin e studimit “Master i Shkencave” zotërojnë diplomën “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite.
<b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e	Studentët i plotësojnë kriteret e pranimin të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Dokumentacioni në dosjen e tyre përmban ndër të



<p>Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>tjera:</p> <p>Diplomën e Shkollës së mesme (provimin e Maturës Shtetërore), ose ekuivalenten e saj të njohur nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Diplomën e Ciklit të Parë (Bachelor)</p> <p>Zotërimin e gjuhës angleze ose çertifikatë ndërkombëtare të njohjes së gjuhës angleze, ku sipas Udhëzimit nr. 11 të MASR, datë 10.04.2017 kërkohet niveli B1 – C1.</p> <p>Kriteret e regjistrimit të studentëve propozohen nga Fakulteti i Ekonomisë dhe u dërgohen për miratim Senatit Akademik. Më pas bëhet publikimi i kriterëve, afishohen në vende të dukshme brenda IKT, si dhe on-line në faqen web.</p> <p>Ky është Program i ri dhe ka vetëm dy vjet që është aktivizuar, megjithatë gjatë vizitës në institucion u konstatua se Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programet e studimit.</p> <p>Stafi i KU “CIT” organizon dhe takime/workshope si dhe vizita në shkollat e mesme, për të prezantuar programet që ofrojnë por edhe për të mbledhur informacion dhe mendime për përmirësimin e politikës së rekrutimit në vitet në vazhdim.</p>
<p><b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>KU “CIT” ka krijuar Qendrën e Planifikimit të Karrierës, e cila e kryen veprimtarinë e saj në kuadër të zyrës së planifikimit të karrierës dhe studentëve të Diplomuar. Qendra orienton studentët në procesin e zhvillimit të ardhshëm dhe ndërmjetëson komunikimin ndërmjet studentëve dhe institucioneve apo kompanive të ndryshme me qëllim punësimin e studentëve të diplomuar. Gjithsesi studentët që janë në vitin e dytë akademik, janë të tërë të punësuar.</p> <p>Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se studentët kanë informacion mbi njohjen e diplomës brenda dhe jashtë vendit si dhe akreditimit të saj.</p>
<p><b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se sekretaria mësimore disponon numrin e studentëve që janë rregjistruar dhe larguar nga programi i studimit dhe mban dosjet e secilit student.</p> <p>Sekretaria mban të gjithë dokumentacionin e nevojshme lidhur me regjistrimin dhe ecurinë akademike të studentëve, duke përfshirë regjistrin themeltar, regjistrat e lëndëve mësimore që mbajnë të dhëna mbi frekuentimin e studentëve si dhe procesverbalet e provimeve.</p>

*[Handwritten signatures]*



**Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni ka ngritur zyrën Alumni e cila shërben për mbajtjen e të dhënave për studentët e diplomuar. Por për këtë program studimi nuk ka student ende të diplomuar dhe kjo zyrë nuk disponon bazën e të dhënave.</p>
--	---

**Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe vecanërisht nga takimi me grupin e studentëve, GVJ konstatoi se studentët informohen që në momentin rregjistrimit mbi programet e studimit, syllabuset si dhe statusin e akreditimit të programit.</p> <p>Studentët përpara se të futen në provimin përfundimtar njoftohen me të gjitha pikët e marra sipas syllabusit.</p> <p>Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi se studentët kishin mundësitë të komunikonin me përgjegjësin e modulit për çdo paqartësi apo ankesë që mund të kishin në lidhje me provimin.</p>
---	--

**Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e këshillimit të karrierës e ngritur pranë KU «CIT» iu ofron shërbimin e këshillimit studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon në trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>Në këtë program studimi të gjithë studentët e vitit të dytë dhe një pjesë e studentëve të vitit të parë janë të punësuar. Gjithsesi KU «CIT» ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë organizata publike dhe jo publike, të cilat i mundësojnë studentëve zhvillimin e praktikës profesionale.</p>
---	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Studentët e pranuar në në programin e studimit plotësojnë kriteret e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profilet përkatëse.

KU «CIT» i informonte studentët në lidhje me programin e studimit që ofron dhe me politikat e punësimit të studentëve. Në këtë program studimi, pjesa më e madhe e studentëve janë të punësuar.

KU «CIT» disponon statistika për numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi si dhe për studentët e diplomuar, por nga programe të tjera studimi që ofrohen nga KU «CIT», pasi programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile, nuk ka ende të diplomuar.

Studentëve iu ofrohet shërbimi i Këshillimit të Karrierës.

*[Handwritten signatures]*



## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

KU "IKT" i kushton rëndësi kërkimit shkencor dhe ka ngritur pranë çdo Fakulteti si pranë Fakultetit të Ekonomisë edhe pranë Fakultetit të Inxhinierisë Njësinë CIRD (Centre for Innovation, Research and Development). Pranë Fakultetit të Ekonomisë që ofron edhe programin e studimit është ngritur njësi CIRD-Ekonomi e cila ka në fokus kërkimin shkencor, dhe operon në përputhje me misionin e institucionit dhe stafit në lidhje me kërkimin dhe ka si qëllim aplikimin në projekte, aplikime për grante, organizimin e konferencave shkencore, publikime të ndryshme, etj. IKT inkurajon stafin për të realizuar kërkime shkencore dhe ka botimin e tyre në revista shkencore të ndryshme përfshirë edhe revistën shkencore periodike të vet Institucionit CIT Review Journal, me ISSN. Për ta bërë edhe më konkurruese Revistën Shkencore "CIT Review Journal", në bordin shkencor të saj janë afruar profesorë dhe studiues vendas e të huaj të cilët punojnë në universitete prestigjioze. Në Librin e Rregulloreve janë përcaktuar rregulla të qarta në lidhje me mënyrën e organizimit të revistës shkencore dhe të konferencave shkencore. Institucioni inkurajon çdo departament të realizojë konferencë shkencore në mënyrë që nëpërmjet debatit shkencor të nxiten edhe rezultate shkencore në fushën e kërkimit.

IAL synon të inkurajojë kërkimin shkencor brenda institucionit, por edhe në bashkëpunim me institucione të tjera si dhe me studentët. Synohet inkurajimi i studentëve që të marrin pjesë në projekte të përbashkëta me stafin akademik. Staf i akademik është i përfshirë në botimin e punës shkencore në "CIT Review Journal" dhe revista të tjera ndërkombëtare. IKT organizon rreth dy konferenca shkencore çdo vit. Në aktivitetet, siç janë konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare të viteve të fundit, IKT ka mbështetur pjesëmarrjen e studiuesve të rinj, veçanërisht të studentëve të doktoraturës.

Institucioni ka hartuar Strategjinë e Kërkim Zhvillimit dhe krijimtarisë ku janë përcaktuar qartë politikat për kërkim zhvillimin.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

##### Të dhëna për kërkimin shkencor

Institucioni në mënyrë konsistente vlerëson rezultatin e secilit anëtar të stafit për arritjet në kërkimin shkencor. Institucioni vlerëson kërkimin shkencor të pedagogëve të prezantuar jo vetëm në aktivitete shkencore të organizuara në KU "IKT" por edhe kërkime shkencore me të cilët pedagogët kanë qenë pjesëmarrës në konferenca të ndryshme shkencore kombëtare apo ndërkombëtare dhe publikime në revista shkencore veçanërisht me proces "peer review" dhe me factor impakti.

Stafi akademik merr pjesë në mënyrë aktive në aktivitete shkencore. Staf i akademik nxit studentët për pjesëmarrje në bashkëpunime të kërkimit shkencor. Këtë vit do të zhvillohet konferenca studentore.

##### Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Nga ana sasiore numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL është 52.

##### Numri i projekteve kërkimore të fituara

Numri i projekteve kërkimore të fituara nga personeli akademik është 2. Kjo e dhënë është marrë ng RVB.

**Numri i projekteve të zbatuara**

Nga RVB rezulton se numri i projekteve të zbatuara është 1.

**Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL**

Nga të dhënat rezulton se numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL në dy vitet e fundit kur edhe programi i studimit është funksional është 2, ndërsa gjithsej që nga 2012 janë 11 aktivitete shkencore.

**Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL**

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL është 35.

**Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor**

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor është 3.

**Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor**

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor është 3. Ky numër është në nivel institucional. Institucioni nxit pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete shkencore. Një vit me parë në Konferencën e zhvilluar në Vlorë ka pasur një seksion të vecantë për studentët. Këtë vit do të zhvillohet Konferenca studentore në bashkëpunim me një IAL tjetër private.

**Numri i Çmimeve Kombëtare**

Në RVB paraqitet se është fituar një Cmim Kombëtar. Gjatë takimit u tha se i përket viteve të shkuara dhe jo periudhës apo programit studimor.

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

*CIT Review Journal, november issue 2018 me ISSN*

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Personeli akademik publikon artikuj shkencor dhe merr pjesë në Konferenca shkencore. IAL ka vendosur si objektiv për tu arritur nga stafi 2 publikime në vit. Këto publikime janë në fushën e ekonomisë duke i shërbyer zhvillimit të sektorit të shërbimit.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	

*Handwritten signatures in blue ink.*



